



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:215447

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810353

KPPP.nr. 1649/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, kundër debitorëve 1. “B.Sh.” B.I., me numër unik identifikues 811584714 dhe seli në Deçan, ...; 2. B.Sh., me numër personal ... dhe adresë në Deçan, ..., dhe 3. S.Sh., me numër personal ... dhe adresë në Deçan, ..., duke vepruar sipas prapësimit të debitorit B.Sh., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 285/23, i lejuar me datë 12.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri, me seli në Pejë, jashtë seancës, me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit B.Sh., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 285/23, të lejuar me datë 12.09.2023 nga Përmbartuesi Privat Fatos Shatri.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 285/23, të datës 12.09.2023, kundër debitorëve “B.Sh.” B.I., B.Sh., dhe S.Sh., ashtu që janë detyruar të njëjtit, që mbi bazën e dokumentit përmbartimor Marrëveshjes mbi pengun Nr. 200730297, e datës 27.08.2021, e regjistruar në regjistrin e pengut sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20210916-468, t’ia paguajnë kreditorit borxhin në vlerë prej EUR 13,761.28 (me shkronja: trembëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një euro e njëzet e tetë cent), duke përfshirë edhe kamatën e rregullt dhe kamatë vonesën e arritur deri më tani, si dhe kamatat që do të llogariten deri në pagesën definitive, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij urdhri, debitori B.Sh. me datë 04.10.2023, ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se shumën e kërkuar sipas propozimit për përmbarim e ka të pamundur për ta përmbushur, sepse i duhet kohë deri në përmbushjen e detyrimit që ka ndaj kreditorit. Ka propozuar që për përmbushjen e detyrimit të lidhin një marrëveshje jashtëgjyqësore për riprogramimin e borxhit në mënyrë që të ketë kohë për sigurimin e mjeteve.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk janë të mbështetura në prova siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së dhe se nuk bazohen në asnjë nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Ka shtuar se urdhri për përmbarim është lejuar në bazë të dokumenteve përmbarimore të cilat i plotësojnë kushtet sipas dispozitave ligjore. Më tej, ka theksuar se meqenëse prapësimi i debitorit është protokolluar në zyrën e përmbaruesit privat me datë 04.10.2023, prapësimi si i tillë është ushtruar pas afatit ligjor të përcaktuar për prapësim. I ka propozuar gjykatës që të prapësimin e debitorit ta hedhë poshtë si të pa afatshëm, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 15.09.2023 e ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 285/23, të lejuar me datë 12.09.2023 nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përmbaruesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa, nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori, ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri me datë 04.10.2023.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për procedurën përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, si dhe nisur nga fakti se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 15.09.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 16.09.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 22.09.2023.

Prandaj, meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 04.10.2023, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova që prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatëshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 73, paragrafi 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1649/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.